

LIGJ
Nr.9752, datë 7.6.2007

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8932, DATË 26.7.2002 “PËR DËRGIMIN E NJË
FORCE USHTARAKE SHQIPTARE NË AFGANISTAN, NË KUADËR TË KOALICIONIT
NDËRKOMBËTAR KUNDËR TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 12 pika 3, 78, 83 pika 1 dhe 84 pika 4 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SE SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8932, datë 26.7.2002 “Për dërgimin e një force ushtarake shqiptare në Afganistan, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizimit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1 fjalët “një nënrepart i brigadës së reagimit të shpejtë, së bashku me elementet mbështetëse” zëvendësohen me fjalët “një kompani e Forcave të Armatosura, së bashku me elementet mbështetëse”.

Neni 2

Në nenin 2 fjalët “të nënrepartit” zëvendësohen me fjalët “të kompanisë”.

Neni 3

Ky ligj hyj në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5370, datë 25.6.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**